



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN**

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PLANIFIKIMIT TE ZHVILLIMIT URBAN DHE SHËRBIMEVE
INFRASTRUKTURE
DREJTORIA E EMERGJENCAVE CIVILE

RELACION TEKNIK

OBJEKTI: - " Rikostruksjon i ures kembesore ekzistuese mbi Zallin e Benes ne fshatin Shmil, Njesia Administrative Labinot Mal, Rikostruksjon i ures metalike ekzistuese mbi Perroin e Postakaves ne fshatin Balez e poshtme ,Njesia Administrative Bradashesh ,Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Kushes ne fshatin Shengjin ,Njesia Administrative Gracen ,Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Subasheve ne fshatin Paper ,Njesia Administrative Paper dh Rikostruksion i ures kembesore ekzistuese mbi Perroin e Zaranikes".

Vendndodhja : Fshati Shmil, Njesia Administrative Labinot Mal ; Fshati Shengjin , Njesia Administrative Gracen ; Fshati Paper ,Njesia Administrative Paper ; Lagjja Vullnetari , Lagjja Nr4 , Elbasan

Qellimi: Rikostruksjon i urave te poshteshenuara :

- " Rikostruksjon i ures kembesore ekzistuese mbi Zallin e Benes ne fshatin Shmil , per te mundesuar kalimin e per kalimin e kembesoreve te fshatit Shmil sidomos nxenesit e shkollave qe frekuentojne cdo dite per te shkuar ne shkollen e mesme ne fshatin Qafe.
- Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Kushes ne fshatin Shengjin ndodhur në aksin rrugor te rruges komunale qe lidh fshatrat " Dobaj ,Shingjin dhe Gjorme " te Njesia Administrative Gracen.
- Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Subasheve ndodhur në aksin rrugor te rruges komunale qe lidh fshatrat " Pajun, Paper Sollak ,Matrej etjer te Njesise Administrative Paper.
- Rikostruksion i ures kembesore ekzistuese mbi Perroin e Zaranikes", në lagjjen Vullnetari ,Lagjja nr.4 qe perdoret nga banoret e nje pjese te lagjjes Vullnetari qe ndodhet ne anen perendimore te Perroit Zaranike per tu lidhur me pjesen tjeter te qytetit te Elbasanit.

PËRSHKRIMI I SHKURTËR I GJËNDJES

1. Ura varur per kembesore mbi Zallin e Benes

Ura varur per kembesore mbi Zallin e Benes është me nje hapësire drite e mbështetur mbi litare celiku Ø 32 mm te inkastruar ne dy anet ne dy blloqe ankorimi .

Aktualisht gjendja e ures paraqitet si vijon : Shtresa kaluese prej derrase eshte tejet e amortizuar (derrasat dhe traret terthore dhe gjatesore jane kalbur ose thyer) duke e bere uren te rrezikshme per kalimin e kembesoreve sidomos nxenesit e shkollave qe frekuentojne cdo dite. Elementet kryesore te kostruksjonit

mbajtes qe jane litaret e celikut , tirantet vertikale , profilat metalike qe lidhen me tirantet me morsetat metalike , pilotet mbajtes ne hyrje dhe dalje te ures) jane ne gjendje te mire dhe kane nevojë per lyerje me boje .

Gjendja faktike e ures paraqiten si në fotot e mëposhtme:

Fig.1 Foto te gjendjes ekzistuese



Foto te gjendjes ekzistuese

2. Ura e Përroit të Kushes, në fshatin Shingjin

Ura e Përroit të Kushes, në fshatin Shingjin , Njësisë Administrative Gracen ndodhur në aksin rrugor te rruges komunale qe lidh fshatrat “ Dobaj ,Shingjin dhe Gjorme “ ka këto parametra: Hapësirë drite $H_d = 10$ m ,gjërësi kaluese $B = 5$ m dhe $H = 3.4$ m. Ura është e mbështetur mbi (shpatulla betoni mbi të cilat është betonuar soleta beton arme).

Aktualisht gjendja e ures paraqitet si vijon : Ujrat e perroit te Kushes kane shkaktuar gerryerje e bazamentit te urës duke rrezikuar shembjen e ballnes se e urës nga krahu i djathte i saj e cila rrezikon te nxjerrë jashtë funksionimit këtë urë. Dëmtimi i ballnes ka ardhur si pasojë e gërryerjes së bazamentit rreth 120 cm nen kuoten e tabanit te mbeshtetjes, nga prurjet e përroit të Kushes duke duke rrezikuar serjozisht funksjonimin e ures deri ne rrezikim te shembjes totale te ures.

Relacion Teknik




Foto te gjendjes ekzistuese

3.Ura e Përroit të Përroit të Subasheve, në fshatin Paper

Ura e Përroit të Subasheve, në fshatin Paper , Njësisë Administrative Paper ndodhur në aksin rrugor te rruges komunale qe lidh fshatrat “ Pajun, Paper Sollak ,Matrej etjer “ ka këto parametra: Hapësirë drite $H_d = 2$ m ,gjërësi kaluese $B = 5$ m dhe $H = 2$ m. Ura është e mbështetur mbi (shpatulla betoni mbi të cilat është betonuar soleta beton arme).

Aktualisht gjendja e ures paraqitet si vijon : Ujrat e Perroit te Subasheve kane shkaktuar gerryerje e bazamentit te urës duke rrezikuar shembjen e dy ballnave te ures e cila rrezikon te nxjerrë jashtë funksionimit këtë urë. Dëmtimi i ballnave ka ardhur si pasojë e gërryerjes së bazamentit rreth 80 cm nen kuoten e tabanit te mbeshtetjes, nga prurjet e përroit të Paprrit duke duke rrezikuar serjozisht funksjonimin e ures deri ne rrezikim te shembjes totale te ures.



Foto te gjendjes ekzistuese

4. Ura metalike mbi Përroin e Zaranikes , në lagjjen Vullnetari ,Lagjja nr.4

Ura metalike mbi Përroin e Zaranikes , në lagjjen Vullnetari ,Lagjja nr.4 qe perdoret nga banoret e nje pjese te lagjjes Vullnetari qe ndodhet ne anen perendimore te Perroit Zaranike per tu lidhur me pjesen tjeter te qytetit te Elbasanit. Ura ka këto parametra: Hapësirë drite $H_d = 20$ m ,gjërësi kaluese $B = 1.4$ m dhe $H= 4.2$ m.Ura është e mbështetur mbi (shpatulla betoni mbi të cilat është vendosur mbistruktura metalike mbi te cilen eshte betonuar nje shtrese betoni me trashe $t=10$ cm e cila sherben si shtrese kaluese e ures.

Aktualisht gjendja e ures paraqitet si vijon : Ura metalike nuk ka parrake metalike dhe si e tille perben rezik per banoret qe perdorin kete ure sidomos nxenesit e shkollave.



Foto te gjendjes ekzistuese

QËLLIMI I PROJEKTIT

Ky projekt kryhet për objektet : " Rikostruksjon i ures kembesore ekzistuese mbi Zallin e Benes ne fshatin Shmil , Rikostrukson i ures ekzistuese mbi Perroin e Kushes ne fshatin Shengjin ,Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Subasheve ne fshatin Paper dhe Rikostruksion i ures kembesore ekzistuese mbi Perroin e Zaranikes", në lagjen Vullnetari ,Lagjja nr.4 per te mundesuar mbrojtjen nga shkaterrimi i urave dhe per te siguruar kalimin e sigurve te kembesoreve ne urat kembesore dhe kalimin e mjeteve ne rruget komunale .

PUNIMET QE DO TE KREYHEN DHE VOLUMET E PUNIMEVE

1. *Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : " Rikostruksjon i ures kembesore ekzistuese mbi Zallin e Benes ne fshatin Shmil, Njesia Administrative Labinot Mal ", jane :*
 - Zevendesimin total te shtreses se derrases dhe binareve mbajtes te shtreses se derrases ures varur .
 - Lyerje me boje te litareve te celikut
 - Lyerje te pjeseve metalike te ures
2. *Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : " Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Kushes ne fshatin Shengjin ,Njesia Administrative Gracen ", jane :*
 - Beton C 20/25 per perforcimin e kembes se ures me permasa (6*2*1) m
 - Gabjon me rrjete gabjoni me gure kave me permasa (2*1*1) m per forcim bazamenti te
 - Beton C 16/20 per mbishtrere mbi gabjone.
3. *Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : "Rikostruksion i ures ekzistuese mbi Perroin e Subasheve ne fshatin Paper ", jane :*
 - Gabjon me rrjete gabjoni me gure kave me permasa (2*1*1) m per forcim bazamenti te
 - Beton C 16/20 per mbishtrere mbi gabjone.
4. *Punimet kryesore qe do te kryhen per objektin : Rikostruksion i ures kembesore ekzistuese mbi Perroin e Zaranikes", në lagjen Vullnetari ,Lagjja nr.4 ", jane :*
 - Prerje te kostrukcioneve metalike kembesore ekzistuese .
 - Furnizim dhe vendosje te parmakeve metalike te rinj per uren kembesore ekzistuese
 - Lyerje te te parmakeve metalike

Volumet e punimeve janë nxjerrë nga planimetria dhe sipas seksioneve tërthore. Janë bërë llogaritjet e kuotave, të tabanit dhe kuota e projektit me qëllim funksionimin sipas parametrave të projektuar për seksionet.

PREVENTIVI I PUNIMEVE

Preventivi i punimeve, specifikimet për objektin " " Rikostruksjon i ures kembesore ekzistuese mbi Zallin e Benes ne fshatin Shmil , Rikostrukson i ures ekzistuese mbi Perroin e Kushes ne fshatin Shengjin ,Rikostrukson i ures ekzistuese mbi Perroin e Subasheve ne fshatin Paper dhe Rikostrukson i ures kembesore ekzistuese mbi Perroin e Zaranikes”, në lagjjen Vullnetari ,Lagjja nr.4 , jane bashkëlidhur projekt-zbatimit që shoqëron këtë relacion.

Preventivi i zbatimit është vlerësuar sipas V.K.M. Nr.216 datë 13.04.2023.

Punoi: Ing.Arian Baku



MIRATOL
DREJTORIA E EMERGJENCEVE CIVILE
Ndricim Sinani

